Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 298/22
Datë/Datum. 12.08
PRISHTINË - PRIŠTINA

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Muhamet Kurtishaj	04.08.2022	12.08.2022	Nr.298/22
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës:

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 01.08.2022, OE **"Ejona"**, ka parashtruar ankesë me nr.**298/22**, kundër njoftimit për **anulim** të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizimi dhe montimi i ashensorëve në DR Ferizaj"** me nr. prok. 214-22-5442-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues **Policia e Kosovës.**
Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, **furnizim**, shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: **78 600,00 €.**
Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së.
Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE OE "Ejona"

(Të përshkruhen dispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).
- Neni 28 i LPP-së – Specifikimet teknike.
- Neni 20.3, 20.8 dhe 2.3 i RRUOPP

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë/**nuk** janë te njëjta.
PRETENDIMI 1) AK ka shkelur 28 Specifikimet Teknike dhe rregullat 20.3, 20.8 dhe 2.3. AK ne DT iu është referuar një prodhuesi specifik duke futur këtu edhe specifikacionet e ashensorëve. Në tabelën e Specifikimeve teknike, ne kemi shkruar specifikimet e prodhuesit partner te cilat përputhen me kërkesat e AK si dhe janë ne përputhshmëri 100% me EN 81;20/50.

Mirëpo, AK vendose te na eliminoje nga gara, pasi qe ka kërkuar kabinën e një prodhuesi specifik (përkatësisht KLEEMANN) me emrin Classic ATHENA, ndërsa ne kemi ofertuar me kabinën e prodhuesit tone partner e cila është e njëjtë si ajo e kërkuar nga ju (pra me mure te llaminatit). Ndërsa, AK na eliminon pasi qe Kabina e ofertuar nga ne nuk e ka emrin e njëjtë si prodhuesi tjetër ne te cilin janë bazuar.





-Ne kemi ofertuar dimensionet e njëjta sipas standardeve EN 81;20/50 dhe kabina është 60mm me e madhe se ajo e kërkuar(jo me e vogël dhe nuk do duhej te eliminoheshim), pra ne baze te standardit EN81;20/50 prodhuesi e cakton kabinën bazuar ne dimensionet e kafazit.

-AK ka kërkuar 180 nisje për minute, ndërsa ne kemi ofertuar motorin me te avancuar prodhim Italian, me direktivat evropiane i cili mund te shkoje deri ne 210 nisje për minute, dhe AK vendose te na eliminoje sepse kemi ofertuar motor me te mire se ai qe kane kërkuar. -AK ka kërkuar Kontrollorin e një prodhuesi te caktuar, ne kemi ofertuar prodhuesin e partnereve tanë i cili ka kapacitetin e njëjtë me atë te kërkuar nga AK. Mirëpo, AK vendose te na eliminoje pasi qe nuk është i prodhuesit qe e kërkon AK. -AK ne specifikim teknik bazuar ne prodhuesin te cilit i është referuar, ka deklaruar origjinën nga BE për ashensorin. Ne kemi ofertuar me ashensor prodhim TURK, i cili është sipas direktivave evropiane EN 81;20/50.

AK na eliminon për shkak te origjinës dhe si duket nuk ka njohuri për Nenin 28 te LPP ku AK ne asnjë mënyrë nuk guxon te caktoje prodhues specifik apo origjine. -Ia rikujtojmë AK se ne ne specifikimet teknike kemi dhënë deklarate se Ashensori i ofertuar nga ne përputhet me te gjitha kërkesat e AK dhe do jete sipas standardeve evropiane, sipas standardit EN 81;20/50. Një ashensorë mund ti këtë rreth 500 pjese te ndryshme dhe është e pamundur përshkrimi i secilës prej pjesëve, mirëpo me deklarate ne kemi vërtetuar se te gjitha pjesët do te jete te standardeve evropiane si dhe konform specifikimit teknik.

Andaj, për ne është e papranueshme eliminimi nga aktiviteti i prokurimit, për arsye se nuk kemi ofertuar prodhuesin dhe origjinën ne te cilin është bazuar AK ne specifikime teknike dhe vlen shprehja "ekuivalente". Me këtë ankese kërkojmë nga OSHP ta ktheje lenden ne rivlerësim si dhe AK te na shpalle fitues si OE i vetëm i përgjegjshëm ne këtë aktivitet.

KRITERET PËR VLERËSIM

Të vendosen vetëm kërkesa/kriteret që kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit dhe / apo ato kërkesa që lidhen me pretendimet ankimore.

- OE ANKUES është eliminuar me arsyetimin se nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara ne Dosjen e tenderit sipas Aneksit 1 Specifikimet Teknike.
- OE ankues pretendon se oferta e tije është eliminuar pa te drejte dhe ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se sepse oferta e tije i plotëson te gjitha kriteret e kërkuara ne specifikimin teknik te DT.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
(Të përshkruhet vetëm vlerësimi i ofertës së OE ankues /ofertave, par të cilat OE ankues ka pretendime ankimore).

Komisioni i vlerësimit te ofertave pas ekzaminimit dhe krahasimit te ofertave per kete aktivitet te prokurimit, konstatojmë se për këtë projekt janë pranuar 3 oferta, komisioni vlerësues rekomandon si ne vijim:

Anulohet për shkak se asnjë nga ofertat e pranuara nuk janë te përgjegjshme pasi qe nuk i plotësojnë kriteret administrative si dhe nuk i plotësojnë specifikimet teknike te detyrueshme.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Nuk ka marre eksperti shqyrtues informacion shtese.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

OE ankues është pale e interesit ne këtë aktivitet te prokurimit.

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

Nuk ka pasur vendim te me hershem për këtë aktivitet te prokurimit.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

Nuk kemi devijim nga praktikat e me hershme.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES OE "Ejona"

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimi ankimor i OE ankues është se AK ka shkelur 28 Specifikimet Teknike dhe rregullat 20.3, 20.8 dhe 2.3. AK ne DT iu është referuar një prodhuesi specifik duke futur këtu edhe specifikacionet e ashensorëve. Në tabelën e Specifikimeve teknike, ne kemi shkruar specifikimet e prodhuesit partner te cilat përputhen me kërkesat e AK si dhe janë ne përputhshmëri 100% me EN 81;20/50. Ne i plotësojmë kërkesat teknike te dosjes se tenderit etj. Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Ne specifikimin teknik te dosjes se tenderit autoriteti kontraktues ka përdorë emra te prodhuesve për pjesët e pajisje qe ka publikuar tenderin për furnizim. Për shembull është përdorë emri i llojit te kabinës se ashensorit "Clasic Athena A310" qe është e prodhuesit KLEEMANN. Shih foton më poshtë.

CLASSIC A310

The KLEEMANN **Classic Athena A310** cabin is one of the most popular choices for a practical but elegant lift solution.



Marre nga faqja e internetit te prodhuesit KLEEMANN.

Po ashtu është kërkuar prejardhja e pajisjes qe duhet te jete nga shtetet e BE-se. Këto janë ne kundërshtim me nenin 28 pika 7 te LLP-se (Specifikimet e teknike). Nuk është përdorë as shprehja Ekuivalent për rastet kur i referohet një emri te caktuar siç parashihet me këtë dispozite. Mirëpo ne këto raste OE duhet te kërkojnë nga AK gjate fazës se marrjes se dosjes se tenderit qe te largohen specifikimet teknike te cilat bien ndesh me nenin 28 te LPP-se. Nëse AK nuk i ndërron ato, atëherë behet kërkese per rishqyrtim sipas pikës 3.1 te nenit 108/A te LPP-se. Operatori ekonomik ankues nuk e ka shfrytëzuar këtë mundësi.

Autoriteti kontraktues ne specifikimin teknik ka kërkuar qe pajisja e ofruar te jete sipas standardit:EN81-20. Kjo është ne rregulle.

Operatori ekonomik ankues ka ofruar ashensorin e prodhimit te shtetit Turk por qe është i prodhuar sipas standardit:EN81-20 sipas kërkesës së dosjes të tenderit. Ashensori i ofruar nga OE ankues është fakt qe nuk i ka disa elemente te njëjta siç janë te kërkuar ne specifikimin teknik te dosjes se tenderit. Psh është kërkuar te dimensionet e kabinës lartësia 2100 mm, ndërsa është ofruar nga OE ankues 2160 mm, pra 6 cm më i gjate. Mirëpo janë ofruar disa parametra teknik te ashensorit edhe me te mire se qe janë kërkuar, psh. Janë kërkuar

ne DT, Nisjet për minut 180, ndërsa janë ofruar 210/start min, qe është me e mire. Marrë në përgjithësi në aspektin teknik, ashensorit i ofruar nga OE ankues me gjithë këto ndryshime i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit sepse këto ndryshime nuk e zvogëlojnë aftësinë, apo kapacitetet teknike të ashensorit, është i prodhuar sipas standardit te BE i kërkuar në DT, standardi EN81-20.

Kërkesa e AK, që ashensori të jetë me prejardhje nga BE përveç se është e pa arsyeshme është edhe jo ligjore sepse shumë shtete të BE në aspektin teknologjik janë më të dobëta se prodhimet teknologjike të shtetit të Turqisë. E rëndësishme është që produkti i ofruar është prodhuar sipas standardit të BE-së.

Në aspektin teknik, me gjithë devijimet e theksuara nga AK, oferta e OE ankues është në pajtueshmëri me kërkesat e specifikimeve teknike të dosjes së tenderit sepse **nuk ka largime dhe kufizime substanciale** të cilat do ta dallojnë esencialisht nga ato të dosjes së tenderit, nuk afektojnë në parametrat e cilësisë ose ekzekutimin e kontratës dhe devijime të tilla janë të lejuara me nenin 59.4 të LPP-së dhe nenin 41.6 të RRUOPP. Mbi këtë bazë vlerësoj se pretendimi ankimor i OE ankues është i **bazuar**.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Autoriteti kontraktues ka eliminuar ofertën e OE ankues për arsyet se nuk i plotëson kërkesat teknike të DT, mirëpo arsyet e eliminimit për ekspertin shqyrtues edhe në aspektin teknik nuk ka ndikim të cilat do të rezultojnë me përfomancën më të ulët të pajisjes me atë që është kërkuar. Përkundrazi disa parametra teknik të produkti të ofruar nga OE ankues janë më të avancuar se që janë kërkuar në DT. Prandaj vlerësoj se AK nuk ka respektuar në tërësi dispozitat e nenit 59.4 të LPP-së të cilat lejojnë devijime të vogla.

Po ashtu, rekomandoj AK-në që në rastet e tjera gjatë hartimit të specifikimeve teknike te respektoj dispozitat e nenit 28 të LPP-së, në mënyrë që mos ti referohen një artikulli ose burimi të veçantë si në rastin konkret. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e operatorit ekonomik ankues të **aprovohet** si e bazuar.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon autoritetin kontraktues që të bëjë **Rivlerësimin** e ofertave për aktivitetin e prokurimit **"Furnizimi dhe montimi i ashensorëve në DR Ferizaj"** me nr. prok. 214-22-5442-1-2-1 në bazë të dispozitave të LPP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Policia e Kosovës
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - Ejona